



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 08.10.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti lidhur me raportimet APK-DPKI-524/25, DPKI-RQDVUN-0129 dhe DPKI-AOGJDJ-0140, për zyrtarin e lartë z. Bekim Brestovci, Drejtor Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Prishtinës, për shkak se:
 - a) është shmangur gjendja papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik lidhur me të qenurit përfaqësues i autorizuar në biznese private;
 - b) nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, sa i përket dyshimeve për konflikt të interesit lidhur me: mbajtjen e dy pozitave të drejtorit të drejtorive komunale njëkohësisht nga z. Bekim Brestovci; emërimin e tij në pozitën Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, pa kaluar dy (2) vite nga lirimi i tij nga detyra e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Pastrimi" SH.A. dhe angazhimin e motrës së tij (A. B.) në Komunën e Prishtinës;
- II. Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik lidhur me zyrtarin e lartë publik z. Bekim Brestovci, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI) dhe Rregulloren nr. 03/2023 për procedurat për hetimet administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

I. a) - Ky rast (DPKI-524/25), ka filluar të trajtohet pas që është identifikuar dhe më pas është konfirmuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK), se zyrtari i lartë publik z. Bekim Brestovci, krahas ushtrimit të funksionit publik (në atë kohë) Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, është edhe përfaqësues i autorizuar

në tre (3) biznese private "Lina&Kim Consulting" SH.P.K. (Drejtor menaxhues), "BIMET" L.L.C. (Drejtor) dhe "EPC" SH.P.K. (Drejtor).

Agjencia, me shkresën zyrtare DPKI-554/25, e ka njoftuar zyrtarin e lartë publik z. Bekim Brestovci, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin e lartë në Agjenci, me ç'rast i njëjti është njoftuar me pretendimet për konflikt të interesit dhe faktet që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Në takimin e mbajtur dhe përmes komunikimeve me shkrim, Agjencia e ka njoftuar detajisht zyrtarin e lartë për kufizimet dhe ndalesat (absolute) ligjore për situatën në të cilën gjindet, si dhe e ka informuar për veprimet (masat) që duhet t'i ndërmerr për të shmangur gjendjen e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë person i autorizuar në biznes privat, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

"Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni."

Ndërsa, me nenin 15 [Transferimi i të drejtave në drejtimin e ndërmarrjes], të LPKI-së është përcaktuar se:

"1. Zyrtari i lartë nuk mund të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e administrimit dhe drejtimit në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj.

2. Zyrtari i lartë, pronari i aksioneve, gjegjësisht pjesës së kapitalit në një ndërmarrje, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet t'i transferojë të drejtat e administrimit ose menaxhimit, apo drejtimit të ndërmarrjes tek ndonjë person i besuar.

3. Zyrtari i lartë, është i obliguar që në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga zgjedhja, vendosja ose emërimi në detyrën publike, të bëjë transferimin e të drejtave në udhëheqjen e ndërmarrjes në personin e besuar kurse brenda afatit prej pesë (5) ditësh nga data e transferimit të këtyre të drejtave ta njoftojë me shkrim Agjencinë mbi personin e besuar dhe evidencën e transferimit të të drejtave të menaxhimit [...]."

Në cilësi të pozitë së drejtorit të drejtorisë komunale, z. Bekim Brestovci ka status të zyrtarit të lartë publik, në kuptim të nenit 3 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i LPKI-së, me të cilin përcaktohet se: "Zyrtar i lartë – nënkupton zyrtarët e lartë publikë të përcaktuar sipas Ligjit përkatës për deklarimin, kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë", lidhur me nenin 4 paragrafi 1, nënparagrafi 1.34 të Ligjit nr. 08/L-108 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, me të cilin është përcaktuar se: "Për qëllimet e këtij ligji, lista e zyrtarëve të lartë është si më poshtë: [...] Drejtorët e Drejtorive Komunale".

Fakti se z. Bekim Brestovci mbanë pozita në bizneset si më lartë vërtetohet edhe nga Formulari për deklarimin e pasurisë për vitin 2024, të cilin ai e ka bërë në Agjenci më datë 27.03.2025.

Në kuptim të dispozitave si më lartë, Agjencia erdhi në përfundim se zyrtari i lartë z. Bekim Brestovci, gjatë ushtrimit të funksionit publik Drejtor i Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Prishtinës, nuk mund të jet përfaqësues i autorizuar i personave juridikë privat, në këtë rast drejtor menaxhues i subjektit “Lina&Kim Consulting” SH.P.K., e as drejtor i subjekteve “BIMET” L.L.C. dhe “EPC” SH.P.K., për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht gjendje të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Pra, kjo situatë ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1, lidhur me nenin 15 të LPKI-së.

Zyrtari i lartë z. Bekim Brestovci, në takimin e mbajtur, ka pranuar se mban pozitën në bizneset si më lartë, si dhe ka premtuar se menjëherë do të fillojë me procedurat për të bërë ndryshimet e nevojshme për ta shmangur papajtueshmërinë me ushtrimin e funksionit publik.

Më pas, z. Bekim Brestovci me e-maile të ndara ka njoftuar Agjencinë për veprimet që ka ndërmarrë lidhur me biznesin “Lina&Kim Consulting” SH.P.K., si dhe tentimet për veprime që ka bërë lidhur me bizneset “BIMET” L.L.C. dhe “EPC” SH.P.K.

Pasi që z. Bekim Brestovci, përmes e-maileve, disa herë ka njoftuar Agjencinë për veprimet që ka ndërmarrë për t’i bërë ndryshimet në biznesin “Lina&Kim Consulting” SH.P.K., si dhe për tentimin e veprimeve për ndryshime në bizneset BIMET” L.L.C. dhe “EPC” SH.P.K., Agjencia me qëllim të vërtetimit të informatave dhe konstatimit nëse i njëjti ka inicuar procedurat për ndryshime në biznese në ARBK, apo nëse ka bërë ndryshime në bizneset në fjalë, ka kërkuar nga ky institucion informatat dhe dokumentacionin përkatës.

Nga përgjigjet e ARBK-së rezulton se nuk janë bërë kërkesa dhe rrjedhimisht as ndryshime në bizneset në fjalë. Konkretisht, në përgjigjen e ARBK-së të datës 16.06.2025, është theksuar se: *“[...] ju njoftojmë lidhur me kërkesën tuaj, që nuk kemi pranuar kërkesa për ndryshim të përfaqësuesit të autorizuar për këto subjekte [...]”*. Ndërsa në përgjigjen e datës 28.07.2025, është theksuar se: *“[...] gjeni të bashkangjitur historikun e bizneseve, ku tregohet se për bizneset e listuara më poshtë nuk është paraqitur asnjë kërkesë për ndryshim.”*

Rrjedhimisht, veprimet dhe tentimet për të cilat z. Bekim Brestovci ka informuar me shkrim se i ka ndërmarrë, nuk kanë qenë të mjaftueshme për shmangien e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, për derisa ndryshimet e tilla nuk janë bërë në kuadër të bizneseve fillimisht, e më pas edhe të evidentohen në regjistrat publik të bizneseve pranë ARBK-së.

Përkundër kërkesave të vazhdueshme që Agjencia i ka bërë zyrtarit të lartë z. Bekim Brestovci, për të shmangur papajtueshmërinë me ushtrimin e funksionit publik, duke u tërhequr nga mbajtja e funksioneve në biznese private dhe më pas duke evidentuar ndryshimet në regjistrin publik të bizneseve në ARBK, i njëjti nuk i kishte bërë këto ndryshime ashtu sikurse parashihet me dispozitat e sipërcituara.

Pasi që zyrtari i lartë z. Bekim Brestovci nuk kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme për shmangie të situatës së papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, përkatësisht konfliktit të interesit, Agjencia në kuptim të nenit 22 paragrafi 7 të LPKI-së, të njëjti i ka

dërguar “Njoftim paralajmërues për konstatimin e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik” (DPKI-1565/25), me të cilin e ka njoftuar zyrtarin e lartë me konstatimin e situatës së papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, si dhe ka kërkuar nga ai që brenda afatit shtatë (7) ditë nga pranimi të njoftimit, të ndërmerr veprime konkrete (masat) për ta shmangur këtë situatë, konform nenit 19 paragrafi 1, nënparagrafët 1.1, 1.3 apo 1.4 të LPKI-së, me paralajmërimin se: *“në të kundërtën Agjencia do të veproj konform nenit 22 paragrafi 8 dhe nenit 23 të LPKI-së”*.

Pas dërgimit të shkresës “Njoftim paralajmërues për konstatimin e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik”, me të cilin është njoftuar edhe Kryetari i Komunës së Prishtinës (eprori i zyrtarit të lartë), z. Bekim Brestovci ka dërguar në Agjenci informatat dhe dokumentacionin përkatës në lidhje me veprimet që ka ndërmarrë për ndryshimet në bizneset “Lina&Kim Consulting” SH.P.K. dhe “BIMET” L.L.C., ndërsa lidhur me biznesin “EPC” SH.P.K., i njëjti ka theksuar se ky biznes ka status pasiv në ARBK dhe në ATK.

Me qëllim të vërtetimit të statusit (aktual) të bizneseve, Agjencia përsëri ka kërkuar dhe ka marrë përgjigje të ndara nga ARBK, nga ku rezulton se z. Bekim Brestovci ka ndërmarrë veprime sa i përket bizneseve “Lina&Kim Consulting” SH.P.K. dhe “BIMET” L.L.C. (DPKI-2005/25), ashtu që i njëjti është tërhequr nga pozitat e përfaqësuesit të autorizuar në këto biznese, dhe se në këto pozita tani rezulton të jenë persona tjerë.

Kësisoj, sa i përket bizneseve si më lartë, konstatohet se z. Bekim Brestovci ka bërë ndryshimet e nevojshme në këto biznese, ashtu që ka transferuar të drejtat e drejtimit të bizneseve private tek personat e besuar, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, lidhur me nenin 15 të LPKI-së. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë, është shmangur gjendja e papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, sa i përket këtyre bizneseve.

Ndërsa, sa i përket biznesit “EPC” SH.P.K., lidhur me statusin e këtij biznesi, Agjencia ka kërkuar informata nga ARBK dhe nga ATK, nga të cilat institucione zyrtarisht është njoftuar se biznesi në fjalë ka statusin e subjektit pasiv në regjistrat e bizneseve në ARBK dhe në ATK. Konkretisht në përgjigjen e ATK-së është theksuar se: *“[...] statusi pasiv. Që nga themelimi deri në periudhën 11/2010, të gjitha deklaratimet e biznesit për të gjitha llojet e tatimit (të hapura për deklarim) kanë qenë zero (0) euro, ndërsa pas kësaj periudhe nuk figurojnë deklarime të mëtejshme. Biznesi është publikuar në listën e bizneseve pasive më datë 31-03-2014.”* Rrjedhimisht, sa i përket këtij biznesi, Agjencia ka marrë si të mirëqenë faktin se subjekti është pasiv dhe nuk ushtron asnjë aktivitet biznesi, por që z. Bekim Brestovci (deri sa mbanë pozitë të zyrtarit të lartë publik) nuk ka të drejtë që të ushtroj asnjë lloji detyre apo aktiviteti apo të ndërmarrë ndonjë veprim menaxherial, si përfaqësues i autorizuar i këtij biznesi.

I. b) - Gjatë trajtimit të rastit të identifikuar për papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë publik z. Bekim Brestovci, lidhur me zyrtarin në fjalë, Agjencia ka pranuar nga jashtë shkresën e datës 06.05.2025, përmes të cilës është përcjellë kërkesa për vlerësim të konfliktit të interesit, të cilën e ka parashtruar raportuesi i rastit, si dhe raporte tjera DPKI-RQDVUN-0129 dhe DPKI-AOGJDJ-0140, sa i përket dyshimeve për konflikt të interesit me rastin e mbajtjes njëkohësisht të dy pozitave nga z. Bekim Brestovci, konkretisht Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtor i Drejtorisë së Inspektionit në

Komunën e Prishtinës, si dhe pretendimeve për konflikt të interesit për shkak se, siç theksohet në kërkesë, z. Bekim Brestovci ka qenë anëtar i komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Pastrimi" SH.A. dhe ende pa kaluar afati prej dy (2) vjet pas përfundimit të kësaj detyre, është emëruar drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike (është referuar në nenin 18 të LPKI-së). Poashtu, janë parashtruar edhe pretendime lidhur me dyshimet për konflikt të interesit sa i përket angazhimit të motrës së tij (A. B.) si asistente e tij, në Komunën e Prishtinës.

Tutje në raportimet e rastit, janë ngritur pretendime lidhur me (kundër)ligjshmërinë e emërimit dhe mbajtjes së dy pozitave të drejtorit të drejtorive komunale njëkohësisht nga z. Bekim Brestovci, por Agjencia, konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar procedurën e hetimit administrativ duke shqyrtuar raportimet e rastit, vetëm në kontekst të dyshimeve për papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik dhe dyshimeve për konflikt të interesit, sipas dispozitave të LPKI-së.

Kësisoj, Agjencia ka trajtuar dhe shqyrtuar këtë çështje vetëm sa i përket pretendimeve nëse bie ndesh me dispozitat e LPKI-së: emërimi dhe ushtrimi njëkohësisht i dy pozitave Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtor i Drejtorisë së Inspektionit në Komunën e Prishtinës, emërimi i z. Bekim Brestovci në pozitën Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, pa kaluar dy (2) vite nga lirimi i tij nga detyra e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Pastrimi" SH.A., si dhe angazhimi i motrës së tij (A. B.) në Komunën e Prishtinës.

Ndërsa, Agjencia nuk i ka trajtuar pretendimet tjera të cilat nuk kanë të bëjnë me dyshimet për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së, të tilla si organizimi, themelimi apo ndryshimi i strukturës së drejtorive komunale, pasi që çështjet e tilla nuk janë në kompetencë të Agjencisë sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe LPKI-së.

Me qëllim të sqarimit të rastit në kuptim të pretendimeve të ngritura për konflikt të interesit, Agjencia me kërkesa të ndara (DPKI-897/25) ka kërkuar informata dhe dokumentacion nga Komuna e Prishtinës. Institucioni në fjalë, duke u përgjigjur në kërkesat e Agjencisë, ka dërguar informatat dhe dokumentacionin e kërkuar.

Pas grumbullimit të informatave dhe dokumentacionit si më lartë, Agjencia pasi ka administruar si prova (ato që lidhen me vërtetimin e fakteve - pretendimeve për konflikt të interesit), shkresat lidhur me identifikimin e gjendjes së bizneseve, kërkesën anëtarit të Kuvendit Komunal të Komunës së Prishtinës të përcjellur nga MAPL-së, raportimet e raportuesve të rastit dhe dokumentacionin e bashkangjitur, përgjigjet e Komunës së Prishtinës në kërkesat e Agjencisë dhe dokumentacionin e bashkangjitur, informatat, sqarimet dhe dokumentacionin e dërguar nga z. Bekim Brestovci, si dhe dokumentet e siguruar nga Agjencia sipas detyrës zyrtare, ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Me Vendimin nr. 14-101/03-21145/24, i datës 07.02.2024, të Kryetarit të Kryeqytetit, z. Bekim Brestovci është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Kryeqytetit, me efekt nga data 05.02.2024.

Me Vendimin nr. 14-020/04-30329/24, i datës 28.02.2024, të Kryetarit të Kryeqytetit, z. Bekim Brestovci është liruar nga detyra e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Pastrimi" SH.A., në të cilën detyrë ka qenë i emëruar me Vendimin nr. 14-020/04-166012/23, i datës 11.08.2023.

Me Vendimin nr. 14-112/02-34659/25, i datës 10.03.2025, të Kryetarit të Kryeqytetit, z. Bekim Brestovci është emëruar Drejtor i Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Prishtinës, me efekt nga data 07.03.2025.

Me Vendimin nr. 14-118/02-95413/25, i datës 02.07.2025, të Kryetarit të Kryeqytetit, z. Bekim Brestovci është liruar nga detyra Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, me efekt nga data 01.07.2025, dhe në këtë pozitë ka emëruar një drejtor tjetër.

Rrjedhimisht, z. Bekim Brestovci nga data 07.03.2025 deri më datë 01.07.2025, ka mbajtur dhe ushtruar njëkohësisht detyrat e drejtorit të dy drejtorive në Komunën e Prishtinës.

Referuar Vendimit nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016, për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale në Komunën e Prishtinës dhe Vendimit nr. 14-020/04-234572/23, të datës 20.12.2023 për plotësim ndryshimin e këtij vendimi, dhe organogramit të administratës së Komunës së Prishtinës, të cilat Agjencia i ka pranuar nga ky institucion, rezultojnë se drejtoria e shërbimeve publike dhe drejtoria e inspektionit, janë dy njësi të ndara të administratës përkatësisht të pushtetit ekzekutiv të Komunës së Prishtinës, të cilat në rrafshin horizontal janë të të njëjtit nivel. Pra, asnjëra nga këto dy drejtori nuk është organ epror i drejtorisë tjetër.

Sa i përket dyshimeve për konflikt të interesit me rastin e angazhimit të motres së z. Bekim Brestovci në Komunën e Prishtinës, referuar përgjigjes zyrtare të këtij institucioni dhe dokumentacionit të bashkangjitur, rezultojnë se A. B. që sipas konfirmimit të z. Bekim Brestovci, është motra e tij, më datë 11.03.2025, ka bërë kërkesë Komunën e Prishtinës për praktikë në këtë institucion.

Me shkresën nr. ref. 14-113/04-35557/25, e datës 12.03.2025, Menaxheri i Personelit të Komunës së Prishtinës ka njoftuar A. B. se kërkesa e saj është aprovuar, dhe se punën praktike mund ta vazhdojë nga 17.03.2025 deri më 16.06.2025 (3 muaj).

Rrjedhimisht, nga përgjigja e Komunës së Prishtinës dhe dokumentacioni i bashkangjitur, nuk rezultojnë që A. B. të jetë e punësuar në këtë komunë, por e njëjta ka qenë vetëm praktikante. Sikurse që nuk rezultojnë që z. Bekim Brestovci të jetë përfshirë në vendimmarrje, sa i përket angazhimit të saj.

Në vështrim të gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në pikën I. b) të dispozitivit të këtij vendimi, për arsyet si në vijim:

- Sa i përket mbajtjes së dy pozitave të drejtorit të drejtorive komunale njëkohësisht nga z. Bekim Brestovci -

Siç është konstatuar më lartë, nga data 07.03.2025 deri më datë 01.07.2025, zyrtari i lartë z. Bekim Brestovci ka mbajtur dhe ushtruar njëkohësisht detyrat e drejtorit të dy drejtorive në

Komunën e Prishtinës, atë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe atë të Drejtorisë së Inspektionit.

Në vështirim të pretendimeve të ngritura për konflikt të interesit në lidhje me mbajtjen e këtyre dy pozitave nga zyrtari i lartë në fjalë, Agjencia ka konstatuar se me dispozitat e LPKI-së nuk parashihet ndonjë ndalesë (absolute) apo papajtueshmëri me ushtrimin e funksionit publik, që do ta ndalonte mbajtjen dhe ushtrimin e këtyre dy pozitave njëkohësisht, nga z. Bekim Brestovci.

Lidhur me këtë pretendim, Agjencia ka pasur parasysh dispozitën e nenit 13 [Papajtueshmëria me ushtrimin e funksionit publik], paragrafi 2 të LPKI-së, me të cilën është përcaktuar se: *“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike, shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj. Zyrtari i lartë, në cilësinë e anëtarit të organeve të përmendura në këtë paragraf, nuk ka të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me të.”* Por, ka konstatuar se dispozita në fjalë nuk vlenë dhe nuk zbatohet në rastin konkret.

Kjo për faktin se, siç është konstatuar më lartë, sipas vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale në Komunën e Prishtinës, plotësim ndryshimit të këtij vendimi dhe organogramit të administratës së Komunës së Prishtinës, drejtorja e shërbimeve publike dhe drejtorja e inspektionit, janë dy njësi të ndara të administratës - të pushtetit ekzekutiv të Komunës së Prishtinës, përkatësisht nuk janë organe drejtuese të institucionit. Për më tepër, këto drejtori në rrafshin horizontal janë të të njëjtit nivel, pra asnjëra nga to nuk është organ epror i drejtorisë tjetër.

- Sa i përket emërimit të z. Bekim Brestovci në pozitën Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, pa kaluar dy (2) vite nga lirimi i tij nga detyra e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale “Pastrimi” SH.A. -

Agjencia ka trajtuar edhe pretendimin e raportuesit të rastit të parashtruar në formë të shkruar, i cili pretendim ka të bëjë me atë se a bie ndesh me nenin 18 të LPKI-së, emërimi i z. Bekim Brestovci në pozitën Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, pa kaluar dy (2) vite nga lirimi i tij nga detyra e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale “Pastrimi” SH.A.

Me nenin 18 [Kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike], paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të LPKI-së, është përcaktuar se: *“1. Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë: 1.1. të punësohet ose të emërohet, për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik, në pozitë udhëheqëse ose menaxhuese, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin e institucioneve publike dhe private dhe institucioneve vartëse të tyre të cilat kanë marrëdhënie biznesi me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy-vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo sanksionimin e aktivitetit të tyre [...]”*.

Në këtë kontekst, Agjencia ka konstatuar se emërimi zyrtarit të lartë në fjalë në pozitën Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, pa kaluar dy (2) vite nga lirimi i

tij nga detyra e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Pastrimi" SH.A., nuk bie ndesh me dispozitën e nenit 18 të LPKI-së.

Kjo për faktin se, referuar informatave dhe shkresave të lëndës, Agjencia nuk ka gjetur se z. Bekim Brestovci, nga pozita anëtar i komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Pastrimi" SH.A. të ketë mbikëqyrë, kontrolluar apo sanksionuar drejtëpërdrejtë aktivitetin e pozitës Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, sikurse përcaktohet (kusht kumulativ) me dispozitën e nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të LPKI-së.

- Sa i përket pretendimit lidhur me dyshimet për konflikt të interesit në angazhimin e motrës së z. Bekim Brestovci (A. B.) si asistente e tij, në Komunën e Prishtinës -

Lidhur me këtë pretendim, Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 dhe nenit 17 lidhur me nenin 3, të LPKI-së.

Së këndejmi, konflikti i interesit është i lidhur ngusht me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes* privat për vete apo për *personat e afërm* me të.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare"*, ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *"Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje."*

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: *"interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste"*, nënparagrafi 1.6, me të cilin është përkufizuar se: *"Person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë [...]"*, si dhe nënparagrafi 1.12, me të cilin është e definuar nocioni i vendimmarrje si: *"çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik."*

Në rastin konkret, në kuptim dhe zbatim të dispozitave si më lartë të LPKI-së, është fakt se A. B. e cila sipas konfirmimit të z. Bekim Brestovci është motra e tij, ka qenë e angazhuar si praktikante për tre (3) muaj në Drejtorinë e Shërbimeve Publike të Komunës së Prishtinës, por

siç është konstatuar më lartë, z. Bekim Brestovci nuk ka qenë pjesë e procesit vendimmarrës për angazhimin e saj si praktikante, sepse e njëjta është angazhuar sipas një kërkesë që ka bërë në Komunën e Prishtinës më datë 11.03.2025, e cila kërkesë është aprovuar sipas shkresës/njoftimit të datës 12.03.2025, nga Menaxheri i Personelit të Komunës së Prishtinës.


Pjesëmarrja e zyrtarit në *vendimmarrje* dhe ekzistimi i *interesit privat* të zyrtarit në atë *vendimmarrje*, janë kushte *kumulative* të cilat duhet të plotësohen në çdo rast për t'u konsideruar se ka konflikt të interesit në vendimmarrje, sipas dispozitave të nenit 6 dhe nenit 17, lidhur me nenin 3 të LPKI-së. Në këtë rast, nuk rezulton se z. Bekim Brestovci të ket qenë vendimmarrës me rastin e angazhimit të motres së tij si praktikante në Komunën e Prishtinës. Andaj, situata e parashtruar nuk bie ndesh me nenin 6, dhe 17, lidhur me nenin 3 të LPKI-së.

Rrjedhimisht, nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, sa i përket dyshimeve për konflikt të interesit lidhur me: mbajtjen e dy pozitave të drejtorit të drejtorive komunale njëkohësisht nga z. Bekim Brestovci; emërimin e tij në pozitën Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, pa kaluar dy (2) vite nga lirimi i tij nga detyra e anëtarit të komisionit komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Pastrimi" SH.A. dhe angazhimin e motres së tij (A. B.) në Komunën e Prishtinës.

II. Agjencia vendosi si në pikën II. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: "*Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.*", si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: "*Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.*"

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimi të këtij vendimi.


Ylli Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

Vendimi iu dërgohet:

- z. Bekim Brestovci;
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)